



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë datë, 17.07.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.07.2018, të parashtruar nga Operatori Ekonomik *Sporting*, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 18 008 121 nxjerr:

V E N D I M

1. ***Refuzohet*** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik *Sporting* të dt.16.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e komunës së Prishtinës”, me Nr. 616 18 008 121 kundër *Njoftimit për dhënie të Kontratës AK –së*, të datës 04.07.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. *Vërtetohet* vendimi i AK për *dhënien e kontratës* të publikuar me datë: 04.07.2018
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik *Sporting* me datë 16.07.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e komunës së Prishtinës me Nr. të Prok: 616 18 008 121. Autoriteti Kontraktues, me datë

17.07.2018, merr vendim se OE Sporting ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim pas afatit te parapare ne Udhezuesin administrativ të prokurimit publik, si e tillë nuk mund të shqyrtohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit